

MAJ 2022 | Nr. 16

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania



ILD
INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË





ILD PO PUNON QË PUBLIKU DHE POLITIKA TË KENË BESIM SE INSTITUCIONET E REJA TË DREJTËSISË PO FUNKSIONOJNË

Gjatë seancës dëgjimore në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut mbi Raportin Vjetor të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani u është përgjigjur pyetjeve të deputetëve.

I pyetur se sa ndihet i pavarur nga politika dhe ndikimet e brendshme e të jashtme në ushtrimin e detyrës, Z. Metani u përgjigj:

“Bie padyshim dakord që sot arkitektura e re e sistemit të drejtësisë nuk i jep asnjë mundësi politikës, institucioneve politike, interesave financiare apo çfarëdo qoftë, që t’i bëjnë presion magjistratëve në Shqipëri sot.”

Sot, magjistratët në Shqipëri janë të garantuar nga ligji, pikërisht edhe për atë ndarje të mirë të pushteteve, që është bërë nëpërmjet ndarjes së punëve të institucioneve të reja të drejtësisë.

A ndihem unë i presionuar nga politika? Jo! përgjigja ime e shkurtër është jo, sepse Kushtetuta dhe ligji ma kanë dhënë garancinë, që të mos të kemi ndjesi intimidimi nga politika, nga institucionet politike, apo kushdo tjetër, që mund të mendojë t’i bëjë presion Inspektorit të lartë të drejtësisë në çdo formë. Po kam presion nga brenda vetes. Kam presion nga familja; kam presion nga shoqëria; kam presion nga ju, në kuptimin e mirë të fjalës, për pritshmërisë që keni ndaj meje personalisht, por edhe ndaj institucionit, padyshim edhe nga shoqëria. Këto janë



presione të forta, me të cilat njeriu fle në darkë dhe zgjohet në mëngjes. Për këtë arsye edhe gjërat që ju referuat në raport unë i kam ngritur sepse dua që puna të jetë sa më efikase dhe të jetë sa më e shpejtë. Padyshim që çështja e presioneve që vijnë nga politika, këtu është bërë çështje debati, personalisht kam qenë aktiv në reagime edhe publike, me deklarata edhe ndaj ministrave dhe në konferenca publike, së fundmi para një jave, për atë që flitet ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Mendoj që bëhet një kakofoni midis sulmit, kritikës apo intimidimit. Unë mendoj që duhet ta ndajmë në 3 nivele, këtë raport që ka politika me institucionet e gjyqësorit. Së pari janë intimidimet ligjore apo institucionale dhe këto janë fenomene që nuk i shoh, për të qenë të vërtetë, nuk shoh sulme ligjore të nisura nga organet e drejtësisë. Niveli i dytë janë denoncimet, dhe kjo lidhet me një nga pyetjet që ju ngritët, denoncimet që bëhen publikisht, sidomos nga institucionet publike. Sugjeroj që denoncimet të mos bëhen në media, por në institucione, tek Inspektori i Lartë të Drejtësisë apo institucione të tjera dhe të respektohen institucionet dhe standardet e



sistemit, me institucione të pavarura. Të ndalet denoncimi publik i magistratëve që shkelin ligjin. Dhe niveli i tretë është kritika ndaj punës së magistratëve. Çdokush mund të shprehë një mendim për punën e drejtësisë, që mund të jenë kritika apo vlerësime kjo nuk ka rëndësi, unë s'jam i mendimit që në momentin që flet drejtësia të gjithë heshtin.

Çdokush në Shqipëri ka të drejtën të komentojë për vendimet që marrin organet e drejtësisë, por gjetja e kufijve kur flasim për organet e drejtësisë nuk është një pikë e jona e fortë, pasi ka jo pak raste të bullizmit të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Por kjo është çështje e një mjedisi demokratik që duhet të krijojë politika në raport me organet e drejtësisë, kjo nuk është një gjë që thuhet, nuk shkruhet, por është një gjë që ndjehet dhe provohet. Prandaj themi që reforma në Drejtësi do kohën e vet që të japë efektet, sepse për shkak të mjedisit shoqëror demokratik do kohën e vet. Sepse pavarësia e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk mund të funksionojë pa demokraci, dhe e kundërta s'ka demokraci pa pavarësi gjyqësori. Për ta kuptuar këtë sigurisht që

duhet një jetë më vete.

Lidhur me pyetjen nëse ILD është orientuar në veprimtarinë e vet drejt të qenit proaktiv apo reaktiv, Inspektori i Lartë Metani u përgjigj. “Doja të bëja edhe një koment tjetër. Unë mendoj se kemi qenë proaktivë, jo reaktivë, inspektimet apo procedurat që kemi nisur kanë qenë padyshim pjesë e ankesave apo informacioneve të ardhura nga qytetarët, por kanë qenë edhe reagime të institucionit, pikërisht për të dhënë atë mesazhin në publik, që institucionet janë këtu. Edhe pse me vështirësitë e veta ne jemi këtu dhe po punojmë, që publiku dhe politika, në kuptimin e përgjithshëm të fjalës, të kenë besim, që institucionet po

funksionojnë edhe pse është e vështirë për shumë arsye. Jo vetëm për burimet njerëzore, por ajo që është më e rëndësishme, për standardet e punës, që duhet të ngrejë ky institucion i ri, pikërisht për atë peshë që ju thatë. Çdo akt që del nga Inspektori i lartë i drejtësisë vlerësohet nga ILD në mënyrë të hollësishme, jo thjesht për procedurën konkrete, por për standardin që vendos, sepse për ne është shumë e rëndësishme pavarësia e magjistratëve të mos cenohet nga puna e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është shumë e thjeshtë që kjo balancë që nuk është e shkruar gjëkund të shkelet qoftë me një letër të dërguar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.”

ANKETA E ILD

Komunikimi me publikun në funksion të transparencës mbetet një prioritet i vazhdueshëm për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Për të rritur komunikimin me qytetarët, Zyra e ILD ka hartuar dhe publikuar në faqen e internetit një Anketë, përmes së cilës kërkohet mendim mbi punën e deritanishme të institucionit. Anketa mund të plotësohet online ose fizikisht pranë ILD-së.

NË DITËN E DREJTËSISË, ILD FTON QYTETARËT TË SHPREHEN MBI PUNËN E INSTITUCIONIT

Në Ditën e Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë prezanton një mënyrë më shumë të komunikimit të institucionit me qytetarët, një anketë mbi punën e deritanishme.

Qëkur është ngritur si institucioni më i ri i dalë nga reforma në drejtësi, ILD ka patur një vëmendje të posaçme për marrëdhënien me qytetarët, si një mënyrë për t’u përmirësuar dhe rritur besimin e publikut tek institucioni ynë.

Pas rrugëtimit 2 vjeçar, mendojmë se ka ardhur koha, që opinionin e publikut ta vjelim përmes një komunikimi direkt me të, përmes kësaj ankete, e cila mund të plotësohet për vetëm 3 minuta.

Po zgjedhim Ditën e Drejtësisë për ta publikuar këtë Anketë, pasi sic është shprehur Inspektori

i Lartë i Drejtësisë, Z. Metani “Krijimi i respektit për punën e drejtësisë është një përpjekje, që shkon përtej sistemit. Ai është edhe kontribut i faktorëve të tjerë në shoqëri, veçanërisht atyre politikë e mediatikë. Krijimi i një mjedisi demokratik për respektimin e sistemit të drejtësisë nuk është as çështje ligji, as çështje vendimmarrjeje. Kushtetutshmëria, shteti ligjor, respekti për punën e tjetrit apo të asaj që quhet ndarja e pushteteve janë standarde, që duhen ushqyer çdo ditë me largpamësi, jashtë interesit të çastit, duke e mirëmenduar në vizion afatgjatë çdo fjalë të thënë dhe çdo gur të hedhur ndaj sistemit të drejtësisë. Si shoqëri duhet të jemi gati të pranojmë edhe vendime që nuk na pëlqejnë.” Çdo sugjerim, kritikë apo vlerësim i përcjellë përmes kësaj ankete, që mund të plotësohet online ose edhe pranë institucionit të ILD-së, do jetë tejet i cmuar për të orientuar punën tonë në vazhdim.

Linku i anketës: <https://ild.al/sq/ankete/>.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË
Kreu Rreth Nesh Njoftime Legjislacion Si Pranoen Ankesat

Anketë mbi veprimtarinë e ILD-së

1. Sa i informuar jeni mbi funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë? Zgjidhni një ose disa nga pohimet e mëposhtme. *

- Njoh pak sferën e kompetencave të ILD-së.
- Njoh kompetencat e ILD-së, pasi kam lexuar kuadrin ligjor të sistemit të drejtësisë.
- Jam informuar përmes faqes zyrtare të ILD-së.
- Jam informuar nëpërmjet mediave tradicionale/sociale për ILD-në.
- Më kanë informuar të njohur/institucione publike, mbi mundësinë e ankimit ndaj veprimtarisë së magistratëve pranë ILD-së.
- Kam dashur por nuk kam njohur asnjë nga format e komunikimit.

2. A jeni ankuar ndonjëherë për veprimtarinë e magistratëve? *

- Jo, ankohe për herë të parë në ILD.
- Po, kam deponuar ankesë edhe më parë.
- Jo, asnjëherë.

3. A keni përdorur ndonjëherë një ose disa nga format e komunikimit me ILD-në, për ankesa apo informacion? Nëse po, mund të zgjidhni një ose disa nga pohimet e mëposhtme: *

- Kontakti përmes faqes zyrtare: www.ild.al
- Kontakti përmes adresës email: info@ild.al
- Kontakti përmes numrit të telefonit: +35542217217.
- Kontakti fizikisht në ILD, në orarin 09.00-14.00 nga e hëna në të premte.
- Kontakti përmes adresës postare: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Godina 13, Tiranë.

Vazhdo

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË
Kreu Rreth Nesh Njoftime Legjislacion Si Pranoen Ankesat

Anketë mbi veprimtarinë e ILD-së

4. A e keni vizituar faqen zyrtare të internetit www.ild.al? *

- E kam vizituar dhe jam orientuar në lidhje me procedurat e ankimit dhe veprimtarinë e ILD-së.
- E kam vizituar, por nuk jam orientuar në lidhje me procedurat e ankimit dhe veprimtarinë e ILD-së.
- E kam vizituar, por nuk kam mendim për faqen e internetit të ILD-së.
- Nuk e kam vizituar kurrë faqen e internetit të ILD-së.

5. Sa i dobishëm ka qenë për ju informacioni rreth procedurës së ankimit nëpërmjet faqes zyrtare të internetit www.ild.al? *

- I dobishëm, pasi kam marrë informacione në lidhje me plotësimin e formularit të ankesës.
- I dobishëm, pasi kam plotësuar on-line formularin e ankesës.
- I dobishëm, pasi kam shkarkuar formularin e ankesës.
- Nuk është i dobishëm, pasi nuk ka informacione të thjeshta për t'u kuptuar.

6. Si e vlerësoni asistencën/ndihmën e dhënë nga administrata e ILD-së? *

- Më kanë ofruar gjithmonë ndihmë/asistencë kur kam pasur nevojë dhe jam qartësuar plotësisht me të drejtat dhe detyrimet e mia.
- Më është ofruar ndihmë/asistencë, sa për të përmbushur detyrimin formal për të orientuar publikun.
- Jam ende i paqartë, pavarësisht se jam asistuar nga administrata e ILD-së.
- Nuk më është ofruar ndihmë/asistencë, edhe pse e kam kërkuar.

Kthehu
Vazhdo

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË
Kreu Rreth Nesh Njoftime Legjislacion Si Pranoen Ankesat

Anketë mbi veprimtarinë e ILD-së

7. Si e vlerësoni seriozitetin e trajtimit të ankesës suaj? *

- ILD është treguar korrekte dhe më ka njoftuar sipas përcaktimeve ligjore mbi ecurinë e ankesës, përpara afateve.
- ILD ka treguar korrektesë formale dhe më ka njoftuar sipas përcaktimeve ligjore mbi ecurinë e ankesës, në tejkallim të afateve.
- Nuk kam marrë informacion brenda afateve ligjore nga ILD dhe më është dashur të interesohem personalisht mbi ecurinë e ankesës.
- Nuk kam marrë informacion asnjëherë për ankesën e deponuar në ILD.

8. Si e vlerësoni punën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë? *

- Institucion i besueshëm, serioz dhe rigoroz në zbatimin e ligjeve.
- Institucion, që duhet të përmirësohet për të rritur besueshmërinë e publikut tek sistemi i drejtësisë.
- Institucion nga i cili presim rezultate më domethënëse, në verifikimin e veprimtarisë së magistratëve.

Sugjerime mbi përmirësimin e punës së ILD-së:

0 of 2600 max characters.

Kthehu
Dërgo

SEKTORI I NDIHMËS JURIDIKE DHE ANKESAVE



Gjatë asistimit të ankuesve

Komunikimi me qytetarët është pjesë e punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues cdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me


Gjatë muajit *Maj 2022*, Sektori i Ndhmës Juridike dhe Ankesave ka pritur 25 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 30 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.



qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

TAKIME DHE TELEFONATA ME QYTETARËT

■ TAKIME ■ TELEFONATA



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas ligjit dhe komunikon me kërkuesin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik. Kërkesa për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit Maj, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **13 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuesit t'i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankesë, i cili:

- ⇒ mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- ⇒ të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me

email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

⇒ mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.


Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.

STATISTIKA MUJORE

Gjatë muajit **Maj** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **93 ankesa**, **92** nga të cilat janë paraqitur nga qytetarët dhe **1 ankesë** nga institucion.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit MAJ 2022. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”



MAJI I ILD NË SHIFRA

42 vendime arkivimi nga 65 praktika të shqyrtuara:

- ◆ 36 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;
- ◆ 5 vendime arkivimi pas verifikimit (ILD);
- ◆ 1 vendim arkivimi pas verifikimit nga dosje të mbartura nga KLD;
- ◆ 10 vendime verifikimi;

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË INFORMON KOMISIONIN E LIGJEVE MBI PUNËN E INSTITUCIONIT PËR VITIN 2021



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani paraqiti para Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Raportin Vjetor të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit 2021.

Në fjalën e tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë u fokusua në nivelin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2021, ecurinë e punës gjatë vitit 2021, sukseset, sfidat dhe prioritetet në vijim.

Z. Metani iu përgjigj pyetjeve të deputetëve të Komisionit mbi aspekte të ndryshme të veprimtarisë së ILD-së.

Raportin e plotë e lexoni duke klikuar më poshtë: <https://ild.al/sq/2022/05/19/raport-per-vitin-2021/>



PREZANTIMI I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT



E konsideroj edhe unë realisht një mundësi të mirë që të vij para jush dhe të vlerësohet puna e institucionit, si për atë që është bërë mirë, edhe për atë që nuk është bërë mirë, padyshim. Edhe si një mundësi shumë e mirë që unë të shpreh shqetësimin që trupa e inspektorëve dhe unë kemi patur gjatë dy viteve të ekzistencës së ILD-së sepse padyshim që të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që kanë qenë dy vite jo të lehta për ngritjen e një institucioni të ri nga e para, në çdo kuptim, infrastrukturor, burimesh njerëzore, standardesh pune e kështu me radhë.

Ju e keni tashmë Raportin përpara dhe nuk do doja që t'ju lodhja me përshkrim të raportit, por do doja të ndalesha vetëm në pikat e Rezolutës, që ka miratuar Kuvendi vjet dhe sa e si i ka realizuar Inspektori i Lartë i Drejtësisë këto rekomandime të Kuvendit.

Bëhet fjalë për 8 rekomandime, nga të cilat gjysma janë përmbushur dhe gjysma tjetër janë realizuar pjesërisht dhe mbeten në

proces për realizimin përfundimtar, edhe me mbështetjen e Kuvendit, siç do jua paraqes më poshtë.

1. Lidhur me rekomandimin e parë është ngritur dhe vënë në zbatim **sistemi i brendshëm i menaxhimit të çështjeve** për procedurën hetimore, në bashkëpunim me misionin Euralius. Është një sistem që e ka kërkuar vetë ILD, në kuadër të asistencës nga Euralius, pasi na nevojitet për punën e përditshme, lehtësimin e procedurave të qarkullimit të dokumentacionit dhe ruajtjen e sigurisë së të dhënave të mbajtura në të, sipas funksioneve përkatëse, ndarjes së detyrave, dhe trajtimit të dokumentacionit në Zyrën e ILD-së. Aktualisht, sistemi është duke u përdorur kryesisht nga Arkiv-Protokolli, i cili kryen veprime të regjistrimit, skanimit dhe përditësimit të dokumentacionit shkresor për ankesat, si dhe nga inspektorët dhe ndihmësinpektorët, të cilët plotësojnë në sistem dokumentacionin e lidhur me një ankesë. Në të ardhmen, sistemi do ofrojë lehtësira për të gjithë përdoruesit dhe gjenerimin e raporteve/statistikave. ILD e ka marrë në dorëzim si aset nga EURALIUS në janar 2022 dhe e ka pajisur me licencat e nevojshme për përdorimin e tij me afat vlefshmërie deri në gusht të vitit 2022. Në vijim, do merren masa për të bërë kërkesa buxhetore pranë

- Ministrisë së Financave me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të sistemit dhe rinovimin e licensave përkatëse, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e sistemit dhe përmbushja e qëllimeve të tij. Pra, është një rekomandim që vijon të plotësohet.
2. Sa i takon **backlogut**, janë 2104 ankesa dhe praktika në faza të ndryshme trajtimi, të administruara nga ish KLD. ILD ka realizuar ngritjen e bazës së të dhënave me qëllim pasqyrimin e të dhënave të sakta, lidhur me numrin e trajtimit të tyre, objektin, pretendimet e paraqitura në këto ankesa etj., *me qëllim grupimin e tyre dhe hartimin e një radhe përparësie shqyrtimi*. Pas rekrutimit dhe të 8 inspektorëve (magjistratë dhe jo magjistratë), u bë shpërndarja e praktikave në 4 (katër) inspektorë për trajtimin me përparësi të tyre. Është një punë në proces që varet së pari nga kapacitetet njerëzore, ku ILD ka mungesa.
 3. **Bashkëpunimi me Këshillat** dhe institucionet e rivlerësimit kalimtar është shndërruar në praktikë pune sa i takon ILD-së, si për informacion apo listat e përditësuara të magjistratëve në detyrë apo kur u mbaron statusi, me KLGJ e KLP, ashtu edhe me KPK-në. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në çdo rast ka trajtuar me prioritet maksimal dhënien e informacionit ndaj këtyre institucioneve. Pra, ky rekomandim nga ana jonë konsiderohet i përmbushur.
 4. Nga ana tjetër, nga ILD e në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë janë vendosur **ura komunikimi e koordinimi institucional me të dy këshillat**, sa i takon procesit të procedimeve disiplinore, takimeve periodike mes nesh, kjo për të identifikuar problematikat me interes të përbashkët, që hasen gjatë zbatimit të ligjit, dakordësimin dhe koordinimin mbi zbatimin e standardeve uniforme, përmes garantimit të një procesi të rregullt disiplinor e në respekt të pavarësisë së magjistratëve. Ky proces synohet të vijojë si një platformë komunikimi mes tre institucioneve dhe e konsiderojmë një rekomandim të përmbushur.
 5. Për të thjeshtuar e përsheptuar punën e inspektorëve është hartuar **manuali i hetimit disiplinor**, një rekomandim i Kuvendit gjithashtu, që synon të mbështesë interpretimin dhe zbatimin e një kuadri të ri ligjor, sa i përket sistemit disiplinor për gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Shqipërisë. Manuali është i ndërtuar me analizën dhe komentet e dispozitave, format standarde të ndërtuara bazuar në kërkesa të qarta të neneve të ligjit procedural për hetimin disiplinor të shkeljeve të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorë dhe mbulojnë kryesisht procedurat që duhet të ndiqen gjatë procesit disiplinor. Sa i takon **metodologjisë së inspektimit**, ILD për shkak të numrit të pamjaftueshëm të inspektorëve dhe numrit të lartë të ankesave të mbartura, deri tani kanë nisur 3 (tre) inspektime tematike, të cilat janë në vazhdim, konkretisht: *Inspektimi tematik i gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt "Lirimin me Kusht"; Inspektimi tematik mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, si dhe "Inspektimi tematik*

mbi respektimin e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal” për veprën penale “Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”. Pas marrjes së të dhënave nga gjykatat dhe prokuroritë të përfshira në këtë inspektim tematik dhe analizimit të tyre gjatë procedurave inspektuese të ndjekura, për inspektimin tematik për “lirimin me kusht” janë paraqitur 2 kërkesa për procedim disiplinor në vitin 2020 dhe 1 kërkesë për procedim disiplinor gjatë vitit 2021. Ndërsa për dy inspektimet e tjera të sipërpërmendura, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është në proces të analizimit të të dhënave të administruara për secilin inspektim tematik, rezultatet e të cilëve priten të dalin gjatë vitit 2022. Në secilin prej vendimeve është miratuar edhe metodologjia e inspektimit që do të ndiqet. Por, duhet ta them se në këtë fazë të kapacitetit të burimeve njerëzore, kjo masë mbetet e realizuar pjesërisht, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të inspektorëve dhe trajtimit të ankesave të prapambetura nga ish-KLD, KLGJ-së dhe atyre aktuale, por dhe të mungesës së infrastrukturës së nevojshme për realizimin e inspektimeve. Në ndërkohë, nuk kemi ndenjur duarkryq por jemi orientuar drejt fuqizimit të kapaciteteve, si për metodologjinë ashtu edhe inspektimin në vetvete, duke bashkëpunuar me partnerë ndërkombëtarë për të marrë praktikën më të mira të punës, për një proces që ata e kanë traditë, si me partnerë evropianë ashtu edhe amerikanë. Aktualisht, është duke u hulumtuar mbi metodologjitë e disa vendeve evropiane me qëllim përcaktimin e rregullave mbi mënyrën e realizimit dhe hapave procedurale që duhet të ndiqen në një

proces inspektimi. Sa i takon **rregullores së ankesave**, po punohet për ndërtimin e një sistemi të brendshëm të qarkullimit të dokumentacionit, në vlerësim edhe të modeleve të huaja, nga institucione homologe. Prej 10 dhjetorit 2021, ILD është pjesë e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), me statusin e vëzhguesit sepse anëtarët janë vetëm vende të BE, por ka nisur shkëmbimin e praktikave të punës nga shërbimet e inspektimit në vendet evropiane. Bashkëpunimi me këtë rrjet startoi nëntorin e kaluar në Tiranë, ku anëtarë të këtij Rrjeti zhvilluan vizitë pune në Shqipëri dhe trajnime intensive me ekipin e ILD-së. Tashmë edhe ILD po ndan eksperiencën e vet në aktivitete ndërkombëtare që organizon Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë. Ndërsa pas disa javësh, në qershor mikpresim në Tiranë një konferencë ndërkombëtare të këtij Rrjeti, me mbështetjen e Këshillit të Evropës përmes CEPEJ (Komisioni Evropian për Eficencën në Drejtësi).

6. Sa i takon rekomandimit për **përshejtimin e punës me rekrutimet** dhe plotësimin e ILD me kapacitet e nevojshme njerëzore, ILD ka marrë masat që kanë qenë në kapacitetet e veta, por ka nevojë për mbështetje nga Kuvendi i Shqipërisë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vijuar punën me një inspektor të vetëm gjatë vitit të parë të veprimtarisë së tij, pra deri në shkurt 2021, dhe në vijimësi ka kërkuar komandimin e magjistratëve të tjerë pranë këshillave. Nga ana e KLGJ-së janë realizuar shtatë shpallje, për komandimin e magjistratëve gjyqtarë në pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së ILD-së, por asnjëra nuk ka rezultuar e suksesshme në

drejtim të plotësisht të nevojave të ILD-së. Ndërsa nga ana e KLP-së, me përfundimin e procedurave, janë komanduar 4 magjistratë prokurorë, për një periudhë 5 vjeçare. Me shpalljen e vet, ILD ka rekrutuar 4 inspektorë jo magjistratë, duke bërë që numri i inspektorëve në total, sot që flasim të jetë 8, nga 26 që parashikon ligji. Më 30 shtator 2021 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shpallur thirrjen për 9 (nëntë) pozicione për inspektorë jomagjistratë tek njësia e inspektorëve. Po vijon filluar procedura përzgjedhëse për 19 kandidatë, të cilët kanë shprehur interes. Nevojë imperative për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë mbetet plotësimi i njësive të Inspektorëve me Inspektorë magjistratë, sidomos të profilit gjyqtar dhe për këtë janë të nevojshme ndërhyrjet ligjore, të cilave do u kthehem në fund të kësaj ndërhyrjeje.

7. Sa i takon hartimit dhe miratimit të **planit vjetor të inspektimeve institucionale e tematike dhe bërjen publik të tij në faqen zyrtare të institucionit**, puna ka nisur me kërkesën drejtuar KLGJ, KLP dhe PP, për paraqitjen e tematikave apo çështjeve, të cilat mund t'i nënshtrohen inspektimit tematik apo institucional. Prokurori i Përgjithshëm ka propozuar 6 çështje, të cilat mund të jenë objekt inspektimi, e që janë diskutuar në një takim dyditor edhe me partnerë ndërkombëtarë, njëjloj si për vijimin e hartimit të një plani vjetor për inspektimet. Në analizë të mundësive të burimeve njerëzore pranë ILD-së, mundësive financiare për këtë vit, ILD ka vlerësuar se është në kushte të kapacitetit të kufizuar në drejtim të burimeve njerëzore, përvojës institucionale, por edhe të mundësive financiare për të trajtuar të gjitha nevojat dhe përcaktimin e një plani.

Pamundësitë objektive të evidentuara janë të kushtëzuara edhe nga numri i lartë i ankesave të mbartura, por edhe i numrit të lartë të ankesave të paraqitura. Sot që flasim janë rreth 4600 ankesa të administruara në ILD. Në vlerësim të të gjithë faktorëve me impakt në realizimin e inspektimeve, është vlerësuar se mjeti i duhur për adresimin e çështjeve të paraqitura nga Prokurori i Përgjithshëm është zhvillimi i inspektimit tematik mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm". Tashmë ILD i është drejtuar dhe po bashkëpunon me partnerë ndërkombëtarë, të cilët do të asistojnë përmes praktikave më të mira në ndërtimin e një plani vjetor, në zbatim të inspektimeve të përcaktuara në ligjet e reformës në drejtësi, por edhe nga përvoja e deritanishme në funksion të trajtimit të ankesave, duke e vlerësuar në raport me metodologjinë e ndjekur nga homologët europianë. Konkretisht, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka finalizuar memorandume specifike mirëkuptimi për fuqizimin e bashkëpunimit me inspektoratet homologe në Bullgari, Rumani dhe Itali. Pra, është një rekomandim në proces përmbyshjeje.

8. **Promovimi dhe rritja e ndërveprimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qytetarët** është rekomandimi i fundit i Kuvendit për ILD-në në vitin 2022, i përmbyshur plotësisht. Marrëdhënia me publikun shihet nga ILD, jo thjesht si një

detyrim për transparencë, por si një mekanizëm për të ndërtuar besimin e qytetarëve tek institucioni dhe një reputacion solid. Në funksion të këtij vizioni, është bërë ristrukturimi i faqes zyrtare të internetit, ild.al, me dizajn të ri, ku çdokush mund të hulumtojë lehtësisht për të kërkuar informacion në kohë reale. Pjesën kryesore të faqes e zënë aktivitetet, si një tregues transparence mbi punën e ILD-së, por vëmendja e posaçme është për ankuesit. Përmes një rubrike të veçantë, “*Si pranohen ankesat*”, në pjesën më të dukshme të faqes, gjendet informacion i detajuar dhe i thjeshtuar, se si mund të ankohesh në ILD. Kjo rubrikë përmban formularin TIP të ankesës, së bashku me udhëzimet përkatëse mbi mënyrën se si duhet plotësuar. E për të ndihmuar ankuesit janë publikuar një sërë shembujsh mbi vendimet, që merr Inspektori i Lartë i Drejtësisë për raste të pranimit apo jo të ankesave. Rrugëtimi që ndjek një ankesë, nga momenti kur dorëzohet në ILD, pra prej fazës së parë të shqyrtimit, e deri kur përfundon në vendimmarrje, ilustron me një hartë grafike, që e paraqet kuptueshëm procesin për çdo vizitor të faqes. Në faqe janë të publikuara shifrat e ankesave të administruara e që përpunohen çdo ditë nga ILD, të cilat rifreskohen çdo të hënë, në mënyrë që kushdo të kuptojë ritmin e punës së institucionit tonë. Ky proces por edhe veprimtaria e ILD-së, pasqyrohet çdo muaj në Buletinin e institucionit, që përmban edhe statistika të prodhuara nga Zyra e Ankesave e Protokollit, si dhe Koordinatorin për të Drejtën e Informimit. Buletini publikohet çdo muaj në faqen e internetit, në shqip dhe anglisht. Për të lehtësuar komunikimin me ILD-në, në përputhje edhe me të drejtën e qytetarëve

për informim, në dispozicion është një numër telefoni, një adresë zyrtare email, kjo e fundit, edhe për dërgimin e ankesave. Përveç faqes zyrtare, komunikimi me publikun bëhet edhe përmes llogarive në Twitter dhe Youtube. E gjitha në funksion të transparencës sepse mendojmë, se ajo sjell besueshmërinë që të gjithë kërkojmë nga qytetarët. Prej 2 javësh kemi lançuar një anketë në faqen zyrtare të ILD-së për të vjelë mendimin e publikut mbi punën tonë dhe kjo padyshim do na ndihmojë të përmirësohemi në vazhdimësi. Faqja zyrtare e ILD është funksionale dhe e përditësuar në shqip dhe anglisht, për të ofruar më tepër akses dhe lehtësi vizitorëve të faqes, që janë të huaj. Pjesë e komunikimit janë edhe intervistat televizive të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si për edicione informative, për emisione televizive apo shkrime në shtypin e shkruar. Kjo bëhet për ndërgjegjësimin e publikut mbi misionin e ILD, ashtu edhe në kuadër të transparencës mbi veprimtarinë e institucionit apo për problematika që kanë interes publik. Dua të nënvizoj se në këto dy vite aktivitet, zyra e ILD është orientuar tek edukimi i qytetarëve edhe përmes mënyrës së trajtimit të ankesave. Konkretisht, formulimi i vendimeve ka synuar jo vetëm dhe thjesht analizën e ankesave, verifikimin e fakteve dhe praktikave, por shpesh nëpërmjet tyre, është synuar sqarimi, informimi dhe edukimi i ankuesve me dispozitat ligjore duke përfshirë interpretimin dhe leximin e drejtë të tyre.

Kaq sa i takon rekomandimeve të lëna nga Kuvendi, por dua të shfrytëzoj këtë rast për të risjellë në vëmendje sfidën e vazhdueshme të ILD-së për plotësimin e vendeve vakante për inspektorë të profilit magjistrat. Plotësimi i

Njesisë së Inspektorëve me inspektorë magjistratë do ndihmonte ndjeshëm procesin e trajtimit të ankesave, si kontingjentit të trashëguar nga ish KLD, ashtu edhe ankesat e ardhura direkt në ILD. Siç e thashë edhe më sipër, të gjitha thirrjet e KLGJ-së kanë rezultuar pa asnjë kandidat të interesuar për pozicionin inspektor- magjistrat pranë ILD-së. Në një vlerësim të kryer nga ana jonë, problematikat që diktojnë nevojën për zgjidhje shkojnë nga koha e gjatë që nevojitet për plotësimin e një kërkesë për komandim nga Këshillat, 12 muaj nga praktika e deritanishme në Këshilla dhe 11 muaj rekrutimi i inspektorëve jomagjistratë në ILD, deri tek kërkesat e ligjit për pozicione të tilla. Me qëllim adresimin e situatës, kërkohet bashkërendim i punës me organet kompetente për të:

- Rishikuar kriteret që duhet të përmbushin magjistratët për t'u komanduar në detyrën e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke reduktuar vitet e përvojës në funksion;
- Komandim të përkohshëm të magjistratit që ka paraqitur kërkesë, deri në kryerjen e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës, ose shkurtimin e afateve për paraqitjen e kërkesave dhe përgatitjen e opinionit nga këshillat;
- Heqjen e kriterit për të pasur numër të barabartë inspektorësh magjistratë dhe jomagjistratë;
- Trajtim të barabartë financiar për inspektorët jomagjistratë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përcjellë projektaktet dhe relacionet përkatëse shoqëruese, për ndryshimet e kërkuara, Ministrisë së Drejtësisë më datë 02.12.2020. Deri në momentin që flasim, nuk ka një përgjigje nga kjo Ministri ndaj propozimit të

ILD-së për ndryshime ligjore.

Si pasojë e mungesës së një përgjigjeje nga Ministria e Drejtësisë, propozimet iu adresuan Kuvendit si draft amendamente të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë ndjekjes me interes të ecurisë së procesit të shqyrtimit të propozimeve ligjore sipas procedurave parlamentare nga komisionet përgjegjëse, u njohëm me kalendarin e punimeve, sipas të cilit projektligjet ishin vendosur për shqyrtim në datën 06.04.2021. Pavarësisht datës së caktuar në kalendarin e punimeve të komisioneve, nga verifikimet e kryera në faqen zyrtare të Kuvendit, për periudhën 06.04.2021, deri në dhjetor 2021, rezulton se nuk ka të publikuar asnjë procesverbal të komisionit përgjegjës apo komisionit për dhënie mendimi, mbi shqyrtimin e nismës së një ish-deputeti për projektligjin nr. 115/2016.

Në këto kushte, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, nevoja e ndryshimeve ligjore, nën dritën e argumenteve të parashtruara më lart, mbetet një prioritet për vitin 2022.

Videon e plotë të Raportimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mund ta ndiqni në kanalin zyrtar Youtube.



ORIENTIMI DREJT VLERAVE QË KONSOLIDOJNË SISTEMIN E DREJTËSISË, SFIDA MË E MADHE PËR TË GJITHË



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani përshëndeti konferencën “Drejtësi në kohë sfidash”, organizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në kuadër të Ditës kombëtare të Drejtësisë.

Duke e konsideruar si një ditë reflektimi për drejtësinë, si një nga vlerat morale më të rëndësishme të një shoqërie, për raportin që drejtësia ka me shoqërinë dhe institucionet e saj, Z. Metani tha se:

“Institucionet e reja të drejtësisë kanë detyrën dhe detyrimin historik të mbajnë gjallë përpjekjet e atyre, që një shekull më parë hartuan dhe miratuan Kanunin e Zhurisë”, pasi janë para një sprove të fortë të besimit publik, dhe si një sfidë e bërë me zgjedhjen e tyre, nuk ka kthim pas.”

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, veçoi në fjalën e tij interesin publik për drejtësinë, duke theksuar se diskutimi i temave që lidhen me drejtësinë, nuk mundet të mos jetë pjesë e debatit publik, por bullizimi i sistemit nuk i shërben askujt.

“Për çështje që lidhen me detyrat e tyre funksionale, magjistratët janë pjesë e kritikave në një nivel të gjërë. Këtë gjë nuk mund ta ndryshojmë, pasi liria e shprehjes i jep të drejtë kujtdo, që të shprehë dhe komentojë lirisht, edhe mbi vendimet e



drejtësisë.

Patjetër që ka raste kur këto komente reflektojnë edhe defektet që shoqëria jonë ka. Nuk ka sesi të ndodhë ndryshe, në një shoqëri në zhvillim, ku gjetja e kufijve nuk është pika jonë e fortë, edhe pse duhet të biem dakort të gjithë, që të paktën bullizimi i drejtësisë, nuk i shërben askujt”.

Në kushtet kur magjistratët, ndryshe nga zyrtarët e tjerë publikë nuk mund të përgjigjen për kritikën që u bëhen, sfida e tyre është transparenca.

“Beteja e gjyqtarëve dhe prokurorëve, zyrtarëve të institucioneve të drejtësisë është me transparencën, është me rritjen e cilësisë së punës.”

Vërtetë që magjistratët nuk mundet të komentojnë mbi vendimet e tyre, por nëse vendimet që ata marrin, shprehin qartë dhe pa asnjë ekuivok, thjeshtë dhe kuptueshëm, drejt dhe pa lakime, mendimin e tyre juridik dhe diskrecionin e tyre të bazuar në ligj, atëherë publiku do të jetë i qartë, se çfarë i duket e drejtë dhe e padrejtë në atë vendim.

Sa më të qartë të jenë gjyqtarët, prokurorët dhe zyrtarët e drejtësisë me vendimet e tyre, sa më të qartë të jenë ata për rolin e tyre, aq më e thjeshtë do jetë edhe për publikun, të njohë rëndësinë e kësaj vendimmarrjeje, e akoma më tej, edhe të krijojë respekt për punën e drejtësisë.”

Nga ana tjetër, vëren Z. Metani, krijimi i respektit për punën e drejtësisë kërkon edhe



kontributin e faktorëve të tjerë në shoqëri sidomos atyre politikë e mediaticë.

“Kushtetushmëria, shteti ligjor, respekti për punën e tjetrit apo të asaj që quhet ndarja e pushteteve janë standarde, që duhen ushqyer çdo ditë me largpamësi, jashtë interesit të çastit, duke e mirëmenduar në vizion afatgjatë çdo fjalë të thënë dhe çdo gur të hedhur ndaj sistemit të drejtësisë.”

Si shoqëri duhet të jemi gati të pranojmë edhe vendime që nuk na pëlqejnë. Zgjidhjet antisistemike vetëm na zgjasin agoninë e vështirësive traumatike, që drejtësia po kalon sot”.

Prandaj sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të gjithë duhet të orientohemi drejt vlerave tona më të mira, për të konsoliduar sistemin e drejtësisë drejt parimeve e standardeve pa kthim.

“Sot e në vazhdim, kjo është sfida më e madhe e të gjithëve ne!”

FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË KONFERENCËN “DREJTËSI NË KOHË SFIDASH”



Ju faleminderit për këtë organizim Znj. Llagami dhe mundësinë për t'u mbledhur në një ditë feste, siç është **Dita e Drejtësisë**.

Është një ditë simbol për drejtësinë dhe shtetin e së drejtës në Shqipëri. Është kënaqësi profesionale të shohësh se ndër dekada e ndër vite, drejtësia shqiptare, me gjithë luhatjet e forta, që ka pësuar për shkak të zhvillimeve politike, sociale e kulturore, ka prodhuar akte drejtësie, që na bëjnë krenarë sot. Historia e drejtësisë evidenton sot juristë dhe profesionistë të

së drejtës, që me mendimin e tyre juridik kanë qenë në avangardë të zhvillimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend. Prandaj sot është dita, që së pari, të kujtojmë dhe nderojmë të gjithë ata, që me kontributet e tyre të spikatura, hodhën themele të forta të shtetit të së drejtës në Shqipëri.

Por, është një ditë edhe për të reflektuar për drejtësinë, si një nga vlerat morale më të rëndësishme të një shoqërie, për rrugëtimin e saj sot dhe nesër në Shqipëri, për raportin që drejtësia ka me shoqërinë dhe institucionet e saj.

Sistemi i drejtësisë në vendin tonë ka bashkudhëtuar me tranzicionin shoqëror dhe në tri dekada pluralizëm kanë shfaqur të njëjtat probleme. Jam i sigurt se përfundimi i fazës së tranzicionit dhe kalimi në fazën e zhvillimit dhe integritit evropian të shtetit shqiptar ka shënuar një pikë të rëndësishme kthese, edhe për drejtësinë shqiptare.

Reforma në drejtësi e vitit 2016 krijoi modelin e shtetit të së drejtës, që duam të ndërtojmë dhe arkitekturën e re të sistemit të drejtësisë.

Institucionet e reja të drejtësisë kanë

detyrën dhe detyrimin historik të mbajnë gjallë përpjekjet e atyre, që një shekull më parë hartuan dhe miratuan Kanunin e Zhurisë.

Institucionet e reja të drejtësisë nuk e kanë mundësinë të bëjnë gabime!

Institucionet e reja të drejtësisë nuk kanë kohë të jenë të qeta!

Jemi përballë një sprove të fortë, përpara atyre që na kanë besuar dhe besojnë tek ne.

Në kufijtë e vështirësisë maksimale, e di!

Por, e tillë është sfida, që ne vetë e zgjodhëm dhe nuk ka më kthim mbrapa.

Jemi të ndërgjegjshëm se krijimi i modelit të shtetit të së drejtës nuk është një proces i lehtë. Ai nuk kërkon vetëm kohë, jo vetëm kapacitete njerëzore dhe financiare, nuk kërkon përpjekje vetëm të sistemit të drejtësisë. Padyshim, pesha themelore në krijimin e kufijve kushtetues e ligjorë të marrëdhënieve shoqërore, mbetet tek sistemi i drejtësisë. Por, roli i faktorëve të tjerë, politikë, shoqërorë dhe ekonomikë është i një rëndësie të veçantë. Një kuadër kushtetues dhe ligjor demokratik është një gur themeli shumë i rëndësishëm në mirëfunksionimin ose jo të një shteti ligjor, por vlerat e së drejtës nuk gjenden vetëm

në ligje të shkruara.

Sado të vlefshme të jenë garancitë kushtetuese, rregullat ligjore formale dhe garancitë institucionale, ato nuk janë të mjaftueshme, nëse nuk ushqehen me vlerat e një shoqërie, që kërkon dhe ndërton një sistem drejtësie të besueshëm, efektiv dhe të pavarur. Parashikimi i garancive formale përbën pikënisjen, por jo përfundimin e këtij procesi.

Drejtësia ka qenë dhe mbetet një nga temat e nxehta, që ngjall interes publik në Shqipëri. Diskutimi i temave që lidhen me drejtësinë, nuk mundet të mos jetë pjesë e debatit publik. Organet e drejtësisë janë pjesë e rëndësishme e strukturës shtetërore dhe për çështje që lidhen me detyrat e tyre funksionale, magjistratët janë pjesë e kritikave në një nivel të gjerë. Këtë gjë nuk mund ta ndryshojmë, pasi liria e shprehjes i jep të drejtë kujtdo, që të shprehë dhe komentojë lirisht, edhe mbi vendimet e drejtësisë. Patjetër, që ka raste kur këto komente reflektojnë edhe defektet që shoqëria jonë ka. Nuk ka sesi të ndodhë ndryshe, në një shoqëri në zhvillim, ku gjetja e kufijve nuk është pika jonë e fortë, edhe pse duhet të biem dakord të gjithë, që të paktën bullizimi i drejtësisë, nuk i shërben askujt.

Megjithatë në këtë kontekst ka edhe një specifike, të cilën dua t'a rinënvizoj.

Ekziston një dallim i rëndësishëm tek kritikant që bëhen ndaj magistratëve dhe kritikave ndaj zyrtarëve të tjerë publikë. Magistratët nuk mund të përgjigjen për kritikant që u bëhen, nuk mund të komentojnë për çështjet e tyre, qoftë edhe për të hedhur poshtë shtrembërimet mediatike apo politike të vendimeve të tyre. Ndryshe nga institucionet që burojnë nga politika, institucionet e pavarura dhe magistratët e kanë këtë lloj kufizimi, që vjen me detyrën.

Kështu që beteja e gjyqtarëve dhe prokurorëve, zyrtarëve të institucioneve të drejtësisë është me transparencën, është me rritjen e cilësisë së punës. Vërtetë që magistratët nuk mundet të komentojnë mbi vendimet e tyre, por nëse vendimet që ata marrin, shprehin qartë dhe pa asnjë ekuivok, thjeshtë dhe kuptueshëm, drejt dhe pa lakime, mendimin e tyre juridik dhe diskrecionin e tyre të bazuar në ligj, atëherë publiku do të jetë i qartë, se çfarë i duket e drejtë dhe e padrejtë në atë vendim. Sa më të qartë të jenë gjyqtarët, prokurorët dhe zyrtarët e drejtësisë me vendimet e tyre, sa më të qartë të jenë ata për rolin e tyre, aq më e thjeshtë do të jetë edhe për publikun, të njohë rëndësinë e kësaj vendimmarrjeje, e akoma më tej, edhe të krijojë respekt për punën e drejtësisë.

Por, nëse gjyqtarët dhe prokurorët duhet të bëjnë punën e tyre, krijimi i respektit për punën e drejtësisë është një përpjekje, që

shkon përtej sistemit. Ai është edhe kontribut i faktorëve të tjerë në shoqëri, veçanërisht atyre politikë e mediatikë. Krijimi i një mjedisi demokratik për respektimin e sistemit të drejtësisë nuk është as çështje ligji, as çështje vendimmarrjeje.

Kushtetutshmëria, shteti ligjor, respekti për punën e tjetrit apo të asaj që quhet ndarja e pushteteve janë standarde, që duhen ushqyer çdo ditë me largpamësi, jashtë interesit të çastit, duke e mirëmenduar në vizion afatgjatë çdo fjalë të thënë dhe çdo gur të hedhur ndaj sistemit të drejtësisë. Si shoqëri duhet të jemi gati të pranojmë edhe vendime që nuk na pëlqejnë. Zgjidhjet antisistemike vetëm na zgjasin agoninë e vështirësive traumatike, që drejtësia po kalon sot.

Sot, Shqipëria është përpara momenteve historike të rrugëtimit të saj europian.

Le të përpiqemi të gjithë, të orientojemi drejt një qasjeje të re përgjegjshmërie!

Le të përpiqemi të gjithë t'i drejtohem vlerave tona më të mira!

Le të përpiqemi të gjithë ta konsolidojmë sistemin e drejtësisë sipas parimeve dhe standardeve, drejt të cilave jemi nisur pakthim.

Sot e në vazhdim, kjo është sfida më e madhe e të gjithëve ne!

Ju faleminderit!

INSPEKTORI I LARTË METANI MERR PJESË NË KONFERENCËN RAJONALE TË SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT TË MESDHEUT JUGOR



Kazablanka, Marok. 11 Maj 2022

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani po merr pjesë në Konferencën dy ditore rajonale për Shërbimet e Inspektimit të Drejtësisë të vendeve të Mesdheut jugor, që po mbahet në Kazablanka të Marokut, organizuar projekti CEPEJ, Komisioni Evropian për efikasitetin e drejtësisë në bashkëpunim me Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Inspektimit (RESIJ), pjesë e të cilit është edhe ILD, si dhe Inspektimin e Përgjithshëm të Çështjeve Gjyqësore të Këshillit të Lartë të Pushtetit Gjyqësor të Mbretërisë së Marokut.

Konferenca bën bashkë përfaqësues të inspektimeve të drejtësisë të vendeve të rajonit jugor të Mesdheut (Egjipti, Jordania, Libani, Maroku, Palestina, Tunizia) dhe disa prej vendeve anëtare të RESIJ (Shqipëria, Belgjika, Bullgaria, Spanja, Franca, Italia, Portugalia, Rumania).

Në fjalën e tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani u ndal tek statuti dhe misionet e inspektimit të drejtësisë, qasja krahasuese mes tyre, si dhe format e ndryshme të organizmit dhe bashkëveprimi me institucionet e tjera.

“Cilësia e drejtësisë është një prioritet i të gjitha vendeve. Përmirësimi i cilësisë së drejtësisë është një proces dinamik dhe në evoluim të vazhdueshëm. Realizimi i këtij qëllimi kërkon një nevojë të vazhdueshme për t’iu përgjigjur sfidave për identifikimin e mekanizmave të rinj të mbrojtjes së tyre. Ka probleme të cilat janë të njëjta për vendet e Bashkimit Evropian. Disa janë në bllok për të gjitha vendet e Këshillit të Evropës dhe të tjera janë specifike për secilin prej tyre.”

Në këtë kuadër, të gjithë ne duhet të bashkëpunojmë. Të gjithë ne duhet të analizojmë dhe bashkërendojmë metodat e

kontrollit dhe të vlerësimit të institucioneve të drejtësisë. Kjo duhet të realizohet nëpërmjet takimeve periodike; shkëmbimit të eksperiencave; unifikimit të metodave dhe praktikave më të mira në përputhje me standardet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës; krijimit të mekanizmave juridik, administrativ apo dhe praktik të bashkëpunimit; shkëmbimit të të dhënave; apo dhe ndihmës juridike të ndërsjelltë ndërmjet shteteve.”, tha mes të tjerash Z. Metani në fjalën e tij në këtë konferencë.

Konferenca përmban një seri modulesh, në të cilat pjesëmarrësit diskutojnë mbi statusin dhe kompetencat e organeve inspektuese të drejtësisë, monitorimin e magjistratëve dhe organizimin e gjykatave, si dhe perspektivat për inspektimet dhe misionet e tyre të reja.

Dita e dytë e konferencës do t'i kushtohet krijimit të Rrjetit Mesdhetar Jugor për Shërbimet e Inspektimit Gjyqësor.



FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË KONFERENCËN RAJONALE TË SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT TË DREJTËSISË TË MESHDEUT JUGOR



*Statuti dhe misionet e inspektimit të drejtësisë:
Një qasje krahasuese
Format e ndryshme të organizimit dhe
bashkëveprimi me institucionet e tjera*

Kazablanka, Marok. 11 Maj 2022

Doja të falënderoja organizatorët e këtij aktiviteti për mundësinë që më dhanë të marr pjesë në këtë konferencë dhe të ndaj me pjesëmarrësit disa mendime dhe konsiderata të miat lidhur me veprimtarinë e shërbimeve të inspektimit të drejtësisë.

Zhvillimi i këtij aktiviteti sot, ofron një platformë të shkëlqyer për shkëmbimin e ideve, ndarjen e eksperiencave, si dhe analizimin e nevojave për gjetjen e zgjidhjeve për sfidat tona të përbashkëta, pasi personalisht mendoj, se sistemi i drejtësisë krahas veçorive dhe specifikave të cilat mund të ketë në vende të ndryshme, ai karakterizohet nga të njëjtat vlera, si dhe funksionon mbi të njëjtat standarde ndërkombëtare dhe parime të organizimit apo funksionimit të tij.

Parimet themelore të aplikuara për organizimin e pushtetit gjyqësor mbështeten në parimin universal të pavarësisë gjyqësore. Gjyqësori i pavarur dhe i paanshëm është institucioni me vlerën më të lartë në çdo shoqëri dhe përbën një shtyllë të domosdoshme të lirisë dhe sundimit të ligjit. Në të njëjtën kohë, në një sistem demokratik, çdo vend duhet të ofrojë një sistem drejtësie të cilësisë më të lartë të mundshme dhe të sigurojë llogaridhënien e pushtetit gjyqësor.

Ndërsa ushtrimi i të drejtës së ankimit dhe kontrolli nga një gjykatë më e lartë dhe brenda vetë pushtetit gjyqësor është mekanizmi i zbatuar tradicionalisht nga sistemet e drejtësisë për të garantuar kontrollin, cilësinë e një procesi gjyqësor, apo bazueshmërinë e së drejtës, sot ky mekanizëm po plotësohet me forma të tjera të jashtme kontrolli për të matur apo mbikëqyrur cilësinë e drejtësisë në kuadër të zhvillimit në mënyrën e duhur të proceseve

gjyqësore dhe menaxhimin efektiv të organeve të sistemit të drejtësisë.

Ky mision i rëndësishëm, lidhur me garantimin e këtyre standardeve i është besuar institucioneve tona, institucioneve të inspektimit.

Në zbatim të akteve ndërkombëtare të cilat proklamojnë standardet ndërkombëtare dhe parimet e organizimit të pushtetit gjyqësor, shërbimet e inspektimit duhet të përshtatin dhe të aplikojnë metodologji të posaçme kontrolli, si dhe ky proces duhet të realizohet gradualisht dhe mbështetur në një sërë kriteresh, standarde dhe garanci të mirëpërcaktuara.

Këto standarde dhe garanci kanë të bëjnë me: (i) bazën ligjore e cila rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve të inspektimit; (ii) format e organizimit dhe funksionimit të tyre; (iii) llojin dhe mënyrën e ushtrimit të kompetencave të kontrollit, mbikëqyrjes apo vlerësimit; (iv) përbërjen, kualifikimin dhe profesionalizimin e punonjësve; (v) pavarësinë substanciale, strukturore dhe financiare; apo (vi) miratimin dhe aplikimin e metodologjive të kontrollit apo vlerësimit të cilat janë të mbështetura në standarde të mirëpërcaktuara paraprakisht.

Në vendet me demokraci të konsoliduar, pushteti ekzekutiv ndonjëherë ka ndikim në vendimmarrjet lidhur me sistemin e drejtësisë. Sisteme të tilla mund të funksionojnë mirë në praktikë dhe të lejojnë një gjyqësor të pavarur, sepse këto pushtete janë të kufizuara nga kultura dhe traditat ligjore, të cilat janë rritur për një kohë të gjatë. Megjithatë, për vendet në trazicion dhe me demokraci të brishtë, të cilat nuk kanë pasur ende një shans për të zhvilluar këto tradita, nevojiten dispozita të qarta



kushtetuese dhe ligjore si një mbrojtje për të parandaluar abuzimin politik.

Një mjet i përshtatshëm për garantimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor është krijimi i institucioneve të inspektimit të cilët janë të pajisur me garanci kushtetuese për përbërjen, kompetencat dhe pavarësinë e tyre. Për sa i përket bazës ligjore e cila rregullon organizimin dhe funksionimin institucioneve të inspektimit vlen të theksohet se duke mbajtur në konsideratë objektin e veprimtarisë së tyre, rregullat lidhur me organizimin dhe funksionimin duhet të përcaktohen qartë dhe në mënyrë shteruese në aktet më të lartë hierarkike legjislative si Kushtetuta apo të paktën në legjislacionin parësor të secilit vend. Kjo shërben si një garanci dhe stabilitet për veprimtarinë e tyre.

Në lidhje me formën e organizimit dhe funksionimit paraprakisht vlerësohet se institucionet inspektimit të sistemit të drejtësisë janë të organizuara në forma të ndryshme, si struktura ekzekutive pranë Ministrisë së Drejtësisë, si struktura pranë organeve *quasi gjyqësore* si Këshillat, organe këto kompetente për administrimin dhe qeverisjen e pushtetit gjyqësor, apo si institucione të pavarura. Në këtë kuadër, vlen të theksohet se nuk ka një model unik dhe të vetëm që të zbatohet për të gjitha vendet

njësoj. Megjithatë pavarësisht formës së organizimit dhe funksionimit, në thelb të veprimtarisë së tyre duhet të qëndrojë respektimi i parimit të ndarjes së pushteteve.

Për sa i përket llojit dhe mënyrën e ushtrimit të kompetencave të kontrollit, mbikëqyrjes apo vlerësimit, kjo mund të ushtrohet në disa drejtime. Së pari duke ndërtuar një sistem përgjegjshmërie dhe llogaridhënës ndaj magistratëve për sa i përket sjelljeve etike dhe veprimtarisë së tyre gjyqësore. Megjithatë, sistemi disiplinor duhet të jetë i qartë dhe transparent, me rregulla të mirëpërcaktuara. Sistemi llogaridhënës i magistratëve nuk duhet të keqpërdoret nga ana e organeve të tjera të pushtetit me qëllim kontrollin dhe cenimin pavarësisë gjyqësore. Për më tepër, duhet mbajtur parasysh kur shqyrtohet përdorimi i masave disiplinore që këto duhet të jenë më tepër një masë e jashtëzakonshme.

Në të njëjtën kohë, efikasiteti i punës së magistratëve nga njëra anë dhe i sistemeve të drejtësisë nga ana tjetër është kusht i domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë individëve, për respektimin e kërkesave të një gjykimi të drejtë, për të pasur siguri juridike dhe për të garantuar besimin e publikut në shtetin e së drejtës. Në këtë kuadër, veprimtaria e magistratëve, por edhe gjykatat, prokuroritë apo institucionet e tjera të drejtësisë duhet t'i nënshtrohen kontrollit apo vlerësimit në aspekt të cilësisë dhe efikasitetit të veprimtarisë së tyre.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm lidhur me organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të inspektimit është garantimi i pavarësisë dhe paanshmërisë së veprimtarisë së tij. Shërbimi i inspektimit duhet të jetë i pavarur



nga ekzekutivi dhe legjislativi dhe nga organi që vendos për vendosjen e sanksioneve disiplinore. Kjo duhet të realizohet nëpërmjet aplikimit të politikave apo masave të cilat synojnë garantimin e pavarësisë substanciale, strukturore dhe financiare të këtyre organeve. Nga ana tjetër për të siguruar besueshmëri dhe legjitimitet duhet që rekrutimi apo përzgjedhja e punonjësve të kryhet në bazë të meritave.

Një pjesë e punonjësve të cilët angazhohen në proceset e kontrollit dhe vlerësimit duhet të jenë magjistratë dhe duhet të zgjidhen nga ana e pushtetit gjyqësor. Ndërsa pjesa tjetër e stafit duhet të zgjidhet mes individëve me kualifikimet e duhura ligjore.

Këshilli i Evropës ka zhvilluar gradualisht një sërë standardesh për efikasitetin dhe cilësinë e drejtësisë, duke u kujdesur për të respektuar dhe mbrojtur pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Kjo është realizuar dhe duke përcaktuar mjete konkrete për të përmirësuar funksionimin e sistemeve gjyqësore në vendet anëtare, si dhe duke lehtësuar zbatimin e instrumenteve ligjore

ndërkombëtare në lidhje me efikasitetin dhe drejtësinë. Legjislacionet kombëtare të vendeve të ndryshme ofrojnë modele të ndryshme të organizmit, funksionimit, apo raporte që organet inspektimit të sistemit të drejtësisë kanë me institucionet e tjera.

Çdo model i përzgjedhur duhet kuptuar si rezultat i zhvillimeve historike, traditës ligjore dhe kushtetuese, apo asaj politike dhe sociale të secilit vend. Këta faktorë diktojnë dhe rezultatin e arritur. Megjithatë, cilësia e drejtësisë është një prioritet i të gjitha vendeve. Përmirësimi i cilësisë së drejtësisë është një proces dinamik dhe në evoluim të vazhdueshëm. Realizimi i këtij qëllimi kërkon një nevojë të vazhdueshme për t'iu përgjigjur sfidave për identifikimin e mekanizmave të rinj të mbrojtjes së tyre. Ka probleme të cilat janë të njëjta për vendet e Bashkimit Evropian.

Disa janë në bllok për të gjitha vendet e Këshillit të Evropës dhe të tjera janë specifike për secilin prej tyre. Në këtë kuadër, të gjithë ne duhet të bashkëpunojmë. Të gjithë ne duhet të analizojmë dhe bashkërendojmë metodat e kontrollit dhe të vlerësimit të institucioneve të drejtësisë. Kjo duhet të realizohet nëpërmjet takimeve periodike; shkëmbimit të eksperiencave; unifikimit të metodave dhe praktikave më të mira në përputhje me standardet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës; krijimit të mekanizmave juridik, administrativ apo dhe praktik të bashkëpunimit; shkëmbimit të të dhënave; apo dhe ndihmës juridike të ndërsjelltë ndërmjet shteteve.

Në të njëjtën kohë, ky proces duhet të realizohet duke mbajtur në konsideratë zbatimin e standardeve të Bashkimit

Evropian të transpozuara në legjislacionet kombëtare; parimet, frymën dhe jurisprudencën Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, apo Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; aktet e Këshillit të Evropës; si dhe në aplikim të metodave, instrumenteve dhe praktikave më të mira të Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), për e cilësisë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor.

REFORMA NË DREJTËSI - INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË TAKON DELEGACIONIN NGA MOLDAVIA



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani zhvilloi një takim pune me Ministrin e Drejtësisë së Moldavisë, Z. Sergiu Litvinenco dhe delegacionin që e shoqëron me përfaqësues nga Parlamenti, Këshilli i Lartë i Magjistraturës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe ekspertë të drejtësisë, në kuadër të vizitës, që po zhvillon në vendin tonë, për t'u njohur me zbatimin e reformës në drejtësi, arritjet dhe mësimet e nxjerra nga ky proces.

Z. Metani e njohu delegacionin nga Moldavia me detyrat dhe funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si institucioni më i ri kushtetues, i pavarur, i

dalë nga reforma në drejtësi, përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Moldavia ka nisur një axhendë reformash për sistemin e drejtësisë, me synim luftën kundër korrupsionit dhe vendosjen e sundimit të ligjit, e në këtë kuadër Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në përgjigje të interesit të delegacionit nga Moldavia, nënvizoi se:

...me gjithë vështirësitë, të pritshme për një proces kaq të thellë, reforma në drejtësi ka krijuar një sistem efikas kundër mundësisë për ndërhyrje ndaj prokurorëve a gjyqtarëve në punën e tyre, vetëm nëse e duan vetë një gjë të tillë, pasi Kushtetuta dhe ligji sot në Shqipëri nuk krijojnë asnjë mundësi, që gjyqtarët e prokurorët të kenë varësi nga çdo institucion politik apo institucione të tjera, që mund t'u bëjnë presion në vendimmarrjet e tyre.

Maj 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë

© ILD




KONTAKT ILD

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko](#) për të ndjekur spotin prezantues të ILD